



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1505, datë 10.02. 2011

Për

“Miratimin e Dokumentacionit Final për Orientimin në kosto të tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.02.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e Dokumentacionit final: Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT

Dokumentacioni i Grupit të Punës të ngritur me Urdhërin e Brendshëm nr.639, datë 15.11.2010, përbëhet nga:

- Projekt vendimi;
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit;
- Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT Dokumenti final;
- Qëndrimi ndaj komenteve të palëve të interesuara.

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 58 dhe 110 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Nenet 1, 2, 106 e në vijim të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
3. Pika 1, germa (e) dhe pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT)” (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (**VKD**) të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
4. Vendimet nr.1210, nr.1211 dhe nr.1212, datë 31.03.2010, të ndryshuara, për shpalljen me FNT dhe vendosjen e masave rregulluese për AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile;
5. Vendimi nr. 1469, datë 24.12.2010, Për “Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT”.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projektvendim i KD të AKEP “Për **Miratimin e Dokumentacionit Final: Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT**” (projektvendimi).
2. Relacioni shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**),
3. Komentet e palëve të interesuara për dokumentin “**Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT-Konsultim Publik datë 24.12.2010**”:
 - a. **Vodafone Albania sh.a.** nëpërmjet shkresës me Referencë CEO/009/E.Xh, datë 31.01.2011.
 - b. **Albanian Mobile Communications sh.a.** me shkresën Nr. Prot.3582/10, datë 28.01.2011;
 - c. **Eagle Mobile sh.a.**, me shkresën Nr.321 Prot, datë 28.01.2011.
 - d. **Plus Communications sh.a.** me shkresën e datës 28.01.2011 (referenca e AKEP: Nr.121 prot, datë 28.01.2011.
4. Dokumentacioni i përgatitur nga Grupi i Punës:
 - a. Qëndrimi ndaj komenteve të palëve të interesuara;
 - b. Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT Dokumenti final.
5. Si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N:

1. AKEP me vendimet nr.1210, nr.1211 dhe nr.1212, datë 31.03.2010, të ndryshuara, për shpalljen me FNT dhe vendosjen e masave rregulluese për AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile, ka përcaktuar se orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT në tregjet përkatës do të kryhet sipas përcaktimeve të vendimeve të veçanta të AKEP, të marra pas një konsultimi publik sipas nenit 58, pika 1 e ligjit nr. 9918.
2. Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr. 1469, datë 24.12.2010, miration nxjerrjen në konsultim Publik të dokumentit: "Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT".
3. Këshillimi publik u krye më datë 29.01.2010, deri më 29.01.2011, dhe nga palët e interesuara kanë dërguar komente në AKEP, katër operatorët celularë: AMC Sh.a., Vodafone Albania sh.a., Eagle Mobile sh.a. dhe Plus Communication sh.a.
4. Dokumentacioni i përgatitur nga grupi i punës:
 - a. Qëndrimi ndaj komenteve të palëve të interesuara;
 - b. Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT Dokumenti final.

bazohet në rezultatet përfundimtare të Modelit BULRAIC të kostove telefonike të operatorëve celularë, të përgatitur nga kompania konsulente ICC, në ligjin nr. 9918 dhe kuadrin rregullator të komunikimeve elektronike, si edhe ka marrë në konsideratë kushtet e tregut dhe praktikat më të mira rregullatore në vendet e BE dhe rekomandimet e KE.

5. Dokumenti "Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT Dokumenti final", përbën një dokument të rëndësishëm mbi të cilin AKEP do të marrë vendime individuale për orientimin në kosto të tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT për shërbimet respektive sipas përcaktimeve të vendimeve nr.1210, nr. 1211 dhe nr. 1212, datë 31.03.2010, të ndryshuara.
6. Dokumenti i cituar në pikën 5 më sipër si dhe vendimet individuale që do merren në bazë të këtij dokumenti, për përcaktimin e metodologjive të rregullimit të tarifave të shërbimeve me shumicë të operatorëve celularë me FNT, për orientimin në kosto, janë të rëndësishme dhe me interes për të gjithë tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendshme të AKEP, e ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të miratojë dokumentat:

- a. Qëndrimi ndaj komenteve të palëve të interesuara për dokumentin “Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT-Konsultim Publik-24.12.2010”, sipas përmbajtjes në Aneks 1;
- b. Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT Dokumenti final, sipas përmbajtjes në Aneks 2.

2. Dokumentat e cituar në pikën 1 më sipër si dhe dokumentat:

- a. BULRAIC celulare_përgjigjet per komentet e konsultimit publik të rezultateve (përgatitur nga ICC)
- b. Mobile BULRAIC Updated Results Consultation Paper Final (përgatitur nga ICC)
- c. BULRAIC Mobile WACC Paper (përgatitur nga ICC)
- d. Komentet e Operatorëve për konsultimin publik për rezultatet e modelit BULRAIC;
- e. Komentet e operatorëve për dokumentin “Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT-Konsultim Publik-24.12.2010”

të publikohen në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A N Ë T A R Ë:

1. Alketa MUKAVELATI

2. Benon PALOKA

3. Ibsen ELEZI

4. Zamira NURÇE

ANEKS 1:

**Qëndrimi ndaj komenteve të palëve te interesuara për dokumentin:
“Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT-
Konsultim Publik-24.12.2010”**

(bashkëngjitur)



**AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE
POSTARE**

**QËNDRIMI I AKEP PËR KOMENTET E
OPERATORËVE PER DOKUMENTIN:¹**

***ORIENTIMI NË KOSTO I TARIFAVE TË SHËRBIMEVE
CELULARE TË OPERATORËVE ME FNT
(KONSULTIM PUBLIK: 24.12.2010)***

Tiranë më 10.02.2011

¹ Dokument i Miratuar me VKD nr.1505, datë 10.02.2011, si Aneks 1 i këtij vendimi.

Në përfundim të procesit të konsultimit publik për dokumentin “Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve celulare të operatorëve me FNT”, i cili është miratuar me VKD nr. 1469, datë 24.12.2010, nga palët e interesuara kanë dërguar komente në AKEP, katër operatorët e telefonisë së lëvizshme në tregun e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë. Ky dokument ka dalë në konsultim publik në faqen e internetit të AKEP me datë 29.12.2010 dhe palëve të interesuara i’u la një muaj kohë, deri më 29.01.2011, për të dërguar komentet e tyre. Operatorët kanë sjellë komentet e tyre me shkresat përkatëse:

Vodafone Albania sh.a. ka sjellë komentet e tij nëpërmjet shkresës nr.ref.CEO/009/E.Xh, datë 31.01.2011.

Albanian Mobile Communications sh.a. ka sjellë komentet në formë elektronike në adresën e AKEP me datë 31.12.2011.

Eagle Mobile sh.a., ka sjellë komentet nëpërmjet shkresës nr.321 Prot, datë 28.01.2011.

Plus Communications sh.a. ka sjellë komentet me shkresën e datës 28.01.2011.

Në këtë dokument paraqitet qëndrimi i AKEP për komentet e operatorëve për dokumentin e nxjerrë për konsultim publik, ndërsa komentet e plota të operatorëve paraqiten në një dokument të veçantë “Komentet e Operatorëve për orientimin në kosto të tarifave celulare”.

AKEP, në aneksin e dokumentit “Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve celulare të operatorëve me FNT”, i nxjerrë në konsultim publik, kishte shtruar katër pyetje të cilat u gjykuan si më kryesoret dhe më të rëndësishmet për procesin e komenteve nga ana e palëve të interesuara, si më poshtë:

1. Cilat janë komentet tuaja në lidhje me propozimin e AKEP-it për përdorimin e vlerës së WACC prej 17.5%?
2. A janë dakord palët e interesuara me reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të terminimit, vlerat dhe afatet kohore të propozuara?
3. A janë dakord palët e interesuara me reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të origjinimit, vlerat dhe afatet kohore të propozuar nga AKEP?
4. A janë dakord palët e interesuara me reduktimin e përshkallëzuar, vlerat dhe afatet kohore si edhe strategjinë e propozuar për tarifatat e terminimit të SMS-ve?

Më poshtë AKEP paraqet komentet kryesore të operatorëve për secilën prej pyetjeve të konsultimit publik dhe qëndrimin e AKEP për komentet e dërguara, dhe më pas paraqiten komentet kryesore për çështje të tjera përveç pyetjeve të mësipërme dhe qëndrimi i AKEP për këto komente.

Pyetja Nr.1: Cilat janë komentet tuaja në lidhje me propozimin e AKEP-it për përdorimin e vlerës së WACC prej 17.5%?

Vodafone Albania sh.a. shprehet se vlera e WACC prej 17.5% duhet të reflektojë draft ligjin e propozuar për rritjen e taksës mbi të ardhurat për operatorët celularë (nëse miratohet) që pritet të hyjë në fuqi shumë shpejt. Sipas këtij propozimi pritet që norma e tatimit për operatorët celularë të rritet ndjeshëm dhe kjo do të ndikojë në rritjen e WACC dhe rrjedhimisht edhe të kostos së terminimit. Vodafone sugjeron që ICC të rillogarisë edhe një herë vlerën e WACC dhe të kostos së terminimit.

Albanian Mobile Communications sh.a. pretendon se vlera e WACC prej 17.5% i korrespondon normës më të ulët të vlerësuar dhe parashtruar nga AMC dhe se kjo vlerë nuk parqet normën e arsyeshme për tregun Shqiptar. AMC, propozon që AKEP të marrë në konsideratë një normë që pasqyron më mirë tregun Shqiptar ose të shpjegojë më qartë se si justifikohet vlera 17.5%.

Plus Communication sh.a. është shprehur se vlera prej 17.5%, merr në konsideratë vetëm koston e kapitalit dhe nuk merr për bazë kosto të tjera operationale si dhe janë përjashtuar oferta/promocionet e operatorëve, si faktorë që ndikojnë në koston e terminimit dhe rrjedhimisht tarifën e terminimit. Plus, shprehet se një shqetësim tjetër është niveli i njëjtë i WACC i propozuar për të gjithë operatorët të cilët janë në faza të ndryshme investimi dhe me profile të ndryshme, si dhe vlera e propozuar nuk mund të përdoret për Plus, pasi ai nuk ka qënë pjesë e të dhënave të dërguara për metodologjinë. Plus, propozon përdorimin e vlerave të ndryshme për operatorë të ndryshëm, si dhe kërkon një argumentim për përdorimin e vlerës 17.5%.

Eagle Mobile sh.a., nuk ka dhënë ndonjë koment konkret lidhur me WACC, duke argumentuar se i qëndron komenteve të mëparshme për modelin se ai referohet të dhënave të vitit 2008, duke ndikuar negativisht tek operatorët e rinj.

Qëndrimi i AKEP:

Nga komentet vihet re se AMC konsideron vlerën 17.5% të ulët, Vodafone nuk komenton për vlerën në kushtet aktuale por kërkon rishikim të saj nëse rritet norma e tatimit fitimit, ndërsa Plus kërkon që vlera të mos jetë e njëjtë për të gjithë operatorët. Gjithashtu operatorët kërkojnë argumentim të vlerës 17.5%.

Për sa i përket komentit të Vodafone, sqarojmë vlera e WACC është para takes dhe ndryshimi i normës së tatimit mbi fitimin nuk ka efekt në vlerën e përlllogaritur të WACC.

Për sa i përket komenteve të Plus në lidhje me kostot operationale, AKEP sqaron se kosto e terminimit të përlllogaritur, përfshin vlerësimin e kostove operationale dhe WACC është kosto e kapitalit të ponderuar, e cila i shtohet këtyre kostove, për të

nxjerrë nivelin e kostos ekonomike të terminimit, që përfshin fitimin e arsyeshëm për sipërmarrësin.

Për sa i përket të dhënave të përdorur në model dhe përfaqësimit të operatorëve, sic është shpjeguar në dokumentat e tjerë të konsultuar për modelin (Dokumenti Reference i Modelit dhe Rezultatet e Modelit), të dhënat e përdorura janë të dhënat historike deri në fund të vitit 2009, duke bërë më pas parashikime për të ardhmen në modelin e tregut. Për më shumë sqarime palët e interesuara mund t'i referohen dokumentave të publikuara të modelit në faqen e internetit të AKEP:

1. Dokumenti Reference i Modelit;
2. Rezultatet e modelit.

Njëkohësisht, AKEP në vijim edhe të komenteve të operatorëve po publikon edhe dokumentat finale të konsulentit në lidhje me rezultatet e modelit dhe të kostos së kapitalit WACC:

- BULRAIC celulare_pergjigjet per komentete konsultimit publik te rezultateve;
- Mobile BULRAIC Updated Results Consultation Paper Final;
- BULRAIC Mobile WACC Paper.

Pyetja Nr.2: A janë dakord palët e interesuara me reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të terminimit, vlerat dhe afatet kohore të propozuara?

Vodafone Albania sh.a. ka rezerva lidhur me vlerat dhe afatet e përshkallëzimit të tarifës së terminimit, duke mos qënë dakord me përshkallëzimin e propozuar në dokument, dhe risjell në vëmendje komentet e dhëna në muajin Korrik 2010 për rezultatet e modelit dhe asimetrinë e propozuar. Vodafone propozon reduktimin e përshkallëzuar sipas vlerave të mëposhtme (propozuar në Korrik 2010):

Periudha	Data e përcaktuar në vendimin e AKEP	Nga shtatori 2011	Nga shtatori 2012	Nga shtatori 2013	Nga shtatori 2014
Tarifa (të gjithë operatorët)	9.13	7.85	6.7	5.6	4.63
Ulja (%)	13%	14%	15%	16%	17%

Vodafone komenton se nëse AKEP nuk merr në konsiderate propozimin e mesipërm, atëherë AKEP duhet të mos devijojë nga propozimi i konsulentit të dhënë në Tabelën 2 të dokumentit për këshillim publik të AKEP.

Albanian Mobile Communications sh.a, lidhur me këtë çeshtje shprehet se është e paqartë lidhur me modelin e përdorur, dhe do të donte një njohje më të thellë të tij. Një shqetësim tjetër është se llogaritjet e tarifës duke u bazuar në mesataren europiane nuk kanë pasqyruar saktë ndryshimet e kursit të këmbimit Lekë/Euro, duke sqaruar se kursi aktual nga koha kur janë bërë llogaritjet ka ndryshuar nga 134 në 139 Lekë/Euro, çka pasqyron një ulje të tarifës në valutë nga 6.7 Eurocent që është marrë si tarifë mesatare e vendeve të BE-së, në 6.4 Eurocent.

Eagle Mobile sh.a, e gjykon shumë të shkurtër periudhën e ruajtjes së nivelit të asimetrisë në favor të tij, duke kërkuar kështu një kohë më të gjatë për të qënë sa më konkurent me dy operatorët e mëdhenj që operojnë prej vitesh në këtë treg. Gjithashtu EM shprehet kundër rregullimit me kostot BULRAIC dhe kërkon përdorimin e mesatares së BE si instrument për rregullimin e tarifave të terminimit.

Plus Communication sh.a shprehet se përshkallëzimi dhe afatet kohore të propozuara në dokument janë të disfavorshme për të. Duke qënë një operator i ri në këtë treg, do ti duhej një kohë më e gjatë për të përfituar asimetrinë e tarifave në raport me operatorët e tjerë. Gjithashtu ai nuk është dakort me vlerat e përshkallëzuara duke pretenduar se brenda 3 vjetëve do t'i duhet të përballet me ulje drastike të tarifës së terminimit. Gjithashtu plus komenton se sipas propozimit asimetria për EM zgjat 5 vjet (2008-2013) ndërsa për Plus 4 vjet 2010-2014, dhe kjo nuk është e drejte për Plus.

Qëndrimi i AKEP:

Nga komentet vihet re se Vodafone dhe AMC këmbëngulin për reduktim/eliminim të asimetrisë shumë më shpejt se propozimi, ndërsa dy operatorët e tjerë EM dhe Plus kërkojnë rritjen apo zgjatjen e afatit të asimetrisë nga nivelet e propozuara.

AKEP, në dokumentin e këshillimit publik ka marrë parasysh përllogaritjet dhe rekomandimet e kompanisë konsulente ICC, dhe ka bërë disa ndryshime të vogla nga varianti final i paraqitur nga konsulenti. Rezultatet finale të modelit dhe rekomandimi final për asimetrinë të konsulentit ICC janë ato që janë dhënë në seksionin 3 të dokumentit të konsultimit publik. Ndryshimet në rezultatet e modelit në fazën të ndryshme kanë ardhur për shkak të ndryshimeve dhe korigjimeve të modelit deri në arritjen e versionit final dhe janë argumentuar nga konsulenti në dokumentat finale që do të publikohen nga AKEP. Në lidhje me asimetrinë e tarifave për katër operatorët, ndryshimet e kryera nga AKEP nga varianti final i konsulentit janë vetëm në fazën e parë për AMC/Vodafone (vetëm 2%)² dhe EM (me vetëm 6%) dhe vetëm në dy fazat e para për Plus Communications. Këto ndryshime janë argumentuar nga AKEP si të arsyeshme pasi:


² Për fazën e parë për AMC/Vodafone është përdorur kursi i këmbimit mesatar të vitit 2009, meqënëse edhe tarifa mesatare e BE (6.7 eurocent) i referohet vitit 2009. Gjithashtu ndryshimet në kursin e këmbimit janë shumë më të vogla se diferenca e tarifës me koston e përllogaritur.

- niveli i propozuar nga AKEP për fazën e parë, për AMC/Vodafone barazon tarifën me mesataren në vendet e BE.
- Aplikimi i tarifave me të larta për dy hyrësit e rinj në treg, në fazat 1 dhe 2 është gjykuar i arsyeshëm nga AKEP, pasi tarifatat e kolonës së parë (tarifat aktuale) për EM janë aplikuar nga data 24.07.2010, ndërsa për Plus Communication nga 27.11.2010 (koha e hyrjes aktive në treg), dhe reduktime më të larta se ato të parashikuara gjykohe të ndikojnë negativisht dy hyrësit e rinj. Ndërkohë reduktimi për dy hyrësit e rinj ruan nivelin aktual të asimetrisë në përqindje dhe ky nivel reduktohet deri në zero në fazat e mëvonshme.

Ndërkohe përsa i përket komenteve të Plus për reduktime më të ndjeshme të tarifës së terminimit në rrjetin Plus se në rrjetet e tjera, rënia e ndjeshme është e pritshme dhe normale për shkak të nivelit prej 80% të asimetrisë aktuale.

Ndërkohe, AKEP duke marrë në konsideratë komentet e operatorëve për asimetrinë relative të tarifave midis operatorëve dhe kohëzgjatjen e asimetrise për Plus, ve re se vlerat e tarifave të terminimit të propozuara nga AKEP janë vërtet në rënie për të gjithë operatorët, por në disa faza asimetria relative midis Plus dhe AMC/Vodafone dhe EM vjen në rritje pas një faze uljeje të saj: në fazën 2 (Shtator 2011) asimetria Plus/EM rritet nga 46% në 53%, në fazën 4 (Shtator 2011) asimetria Plus/EM rritet nga 29% në 43% dhe në të njëjtën fazë asimetria Plus/AMC-Vodafone rritet nga 38% në 43% (për më shumë shiko Figurën e mëposhtme 1).

Figura 1: Ecuria e asimetrise se tariafeve te terminimit te propozuar ne konsultim Publik



Duke qënë se asimetria relative (në përqindje) e tarifave midis operatorëve në treg luan një rol të rëndësishëm dhe se rekomandimet e BE dhe praktikat më të mira rregullatore rekomandojnë që asimetria të vijë në ulje, AKEP gjykon se vlerat e tarifave të terminimit për Plus dhe EM të rishikohen për të shmangur këtë problem. Njëkohësisht, në këtë rishikim AKEP ka marrë në konsideratë komentet e Plus për kohëzgjatje të njëjtë të asimetrisë prej 5 vjet si edhe për EM. AKEP ka bërë një rishikim të vlerave të tarifave të terminimit të propozuara në dokumentin e hedhur për konsultim publik më 29.12.2010, duke bërë disa ndryshime si më poshtë:


- Tarifa e terminimit për t'u aplikuar në rrjetin EM më 01.09.2011 të rritet nga 8.42 në 8.85 lekë/minutë (e njëjtë me tarifën që do aplikohet në rrjetet AMC/Vodafone në periudhën 01.03.2011-31.08.2011);
- Tarifat e terminimit të rekomanduara për Plus për fazat 3 (01.09.2012) dhe 4 (01.09.2013) të ndryshojnë nga 8.42 dhe 6.52 lekë/minutë në 8.85 dhe 6.1 lekë/minutë respektivisht;
- Për Plus tarifa e terminimit të konvergojë me atë të tre operatorëve të tjerë në vlerën 4.57 lekë/minutë në 01.09.2015 në vend të 01.09.2014 të propozuar në konsultim publik, duke aplikuar vlerën 5.3 lekë/minutë në 01.09.2014.

Vlerat sipas këtyre ndryshimeve janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

	Aktuale	1 Mars 2011	1 Shtator 2011	1 Shtator 2012	1 Shtator 2013	1 Shtator 2014	1 Shtator 2015
AMC, Vodafone	10.5	8.85	7.57	6.1	4.57	4.57	4.57
Eagle Mobile	12.92	10.89	8.85	6.52	4.57	4.57	4.57
Plus Communication	18.9	15.93	12.92	8.85	6.1	5.3	4.57

Në bazë të këtyre ndryshimeve, asimetria relative midis operatorëve vjen duke u zvogëluar dhe nuk ka faza me rritje të asimetrise, sic mund të vihet re nga figura 2 më poshtë.

Figura 2: Ndryshimet e asimetrisë midis operatoreve (finale)



Pyetja Nr.3: A janë dakort palët e interesuara me reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të origjinimit, vlerat dhe afatet kohore të propozuar nga AKEP?

Vodafone Albania sh.a., shprehet se nuk është fare në dijeni të një analize për llogaritjen e kostos së origjinimit të thirrjeve dhe duke qënë se nuk ka pasur asnjëherë konsultim publik për këtë çështje, nuk është aspak dakord me këtë lloj përshkallëzimi.

Albanian Mobile Communications sh.a., gjithashtu nuk është dakord që tarifat e origjinimit të thirrjeve të jenë objekt rregullimi në këtë material, po për të njëjtat arsye që parashtrohet edhe Vodafone Albania.

Eagle Mobile sh.a., dhe **Plus Communication sh.a.**, nuk janë objekt i këtij rregullimi dhe nuk kanë dhënë komente për këtë pyetje.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP, sqaron se modeli kishte si ‘output’ kryesor për llogaritjen e tarifave të terminimit, dhe duke gjykuar se kostoja e origjinimit është në nivel pothuajse të njëjtë me atë të terminimit të thirrjeve, diskutimi kryesor është përqendruar në koston e terminimit të thirrjeve. Ndërsa diskutimi nëse duhet të jenë objekt rregullimi apo jo tarifat e origjinimit të thirrjeve, është bërë gjatë analizës së tregut celular në vitet 2009-2010, në përfundim të së cilave AKEP ka dalë me vendimet për FNT dhe detyrime për AMC dhe Vodafone për origjinimin e thirrjeve.

Pyetja Nr.4: A janë dakord palët e interesuara me reduktimin e përshkallëzuar, vlerat dhe afatet kohore si edhe strategjinë e propozuar për tarifatat e terminimit të SMS-ve?

Vodafone Albania sh.a., edhe për këtë çështje shprehet se nuk është fare në dijeni të një analize për llogaritjen e kostos së terminimit të SMS-ve, si dhe nuk ka pasur konsultim publik, ndaj dhe nuk është dakord me këtë lloj përshkallëzimi.

Albanian Mobile Communications sh.a., megjithëse nga njëra anë shprehet se nuk ka një analizë dhe as këshillim publik për llogaritjen e kostos së terminimit të SMS, nga ana tjetër e vlerëson iniciativën e AKEP, rregulloret dhe parimet me ato të BE-së.

Plus Communication: nuk është dakord me rregullimin e tarifave të terminimit të SMS-ve pasi nuk është kryer ndonjë analizë për koston e këtij shërbimi dhe se nuk ka operatorë me FNT për këtë shërbim. AKEP, duhet të ri-konsiderojë qëndrimin lidhur me ndërhyrjen për SMS, qoftë edhe mbi baza rekomandimi.

Eagle Mobile: Shprehet se për këtë shërbim nuk ka analizë për SMS dhe AKEP nuk ka mbështetje ligjore për ndërhyrje.

Qëndrimi i AKEP:

Siç është shprehur edhe më lart për koston e origjinimit të thirrjeve, edhe terminimi i SMS-ve ka qenë objekt i modelit të kostove, megjithëse nuk ka qenë 'output' më i rëndësishëm i tij. AKEP është shprehur në dokumentin e publikuar se tarifatat e terminimit të SMS janë propozuar sipas rezultateve të modelit të konsulentit. Meqenëse kostoja e terminimit është shumë herë më e vogël se tarifatat që aplikohen, dhe fakti tjetër që nuk ka një analizë tregu për shpalljen me FNT të operatorëve në këtë treg, atëherë AKEP e ka parë të arsyeshme që të rekomandojë tarifa të orientuara drejt kostos, të përshkallëzuara në zbritje deri në vitin 2013. Operatorët mund të aplikojnë vetë këto tarifa të rekomanduara të AKEP. Ndërkohë AKEP ka filluar tashmë kryerjen e një analize për FNT për terminimin e SMS-ve dhe do të ndjekë procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 9918 dhe Rregulloren për Analizën e tregut, si edhe rekomandimet e BE dhe praktikën rregullatore në këto vende për këtë shërbim, që siç citohet edhe nga AMC ka praktikë në disa vende të BE për rregullimin e tarifave të terminimit të SMS-ve në rrjetet celulare. AKEP ka planifikuar që dokumenti i analizës për terminimin e SMS-ve të publikohet për konsultim publik rreth fundit të muajit Shkurt 2011, dhe sipas procedurës për konsultim dy mujor të analizës së tregut, AKEP mund të marrë vendime për FNT në këto tregje dhe masat rregulluese përkatëse në varesi të përfundimeve të analizës rreth muajit Maj 2011.

Vlen të theksohet se përcaktimet e Ligjit 9918, lejojnë AKEP të ndërhyjë në rregullimin e tarifave të shërbimeve edhe për operatorë që nuk kanë fuqi të ndjeshme në treg, dhe në këtë rast, bazuar në diferencën midis tarifës së terminimit dhe kostos dhe interesin publik, mund të justifikohet një ndërhyrje e tillë. AKEP do të monitorojë

sjelljen e lojtarëve në lidhje me rekomandimin e mësipërm si dhe alternativat e ndërhyrjeve në rast të mos-reduktimit të vullnetshëm të tarifës së terminimit të SMS-ve nga operatorët celularë.

Komente të tjera

Në komentet e operatorëve ka edhe disa konsiderata të tjera jashtë çështjeve të diskutuara më lart.

Plus Communication sh.a., mendon se nuk mund të jetë objekt i rregullimit të tarifave, pasi dokumenti i paraqitur për këshillim publik merr parasysh vetëm Operatorët FNT, dhe se ai akoma nuk e ka një status të tillë.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP e vlerëson komentin e mësipërm dhe e quan të drejtë shqetësimin e operatorit Plus Communication sh.a., sepse sipas Nenit 45 të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në RSH”, operatorët e shpallur me FNT janë objekt i rregullimit të tarifave.

Megjithatë, duke ju referuar edhe dokumentit të këshillimit publik, AKEP thjesht ka dhënë tarifa orientuese dhe rekomanduese për operatorin Plus Communication sh.a, për sa kohë që ai nuk është shpallur me FNT në këtë treg. Në përfundim të këtij procesi AKEP do të dalë me vendime të veçanta për operatorët AMC, Vodafone dhe EM, të përcaktuar me FNT sipas vendimeve nr. 1210, nr. 1211 dhe nr. 1212, datë 31.03.2010 (të ndryshuara) dhe nuk do të nxjerre vendim për Plus Communication pasi nuk ka status me FNT sipas një vendimi formal të AKEP. Vendimet e AKEP për tre operatore me FNT do të jenë për tarifat e shërbimeve për të cilat operatorët janë me FNT dhe në përputhje me përcaktimet e vendimeve të cituara më sipër për shpalljen me FNT të tyre.

AMC dhe Vodafone kanë komentuar se rezultatet finale të modelit nuk janë publikuar nga AKEP për konsultimin publik të kryer më 10.06.2010-10.07.2010.

Qëndrimi i AKEP:


AKEP në përfundim të këtij procesi së bashku me komentet e operatorëve, qëndrimi i AKEP për komente e operatoreve dhe dokumentin final për orientimin në kosto për konsultimin e kryer më 29.12.2010-29.01.2010 do të publikojë edhe dokumentacionin final për konsultimin publik të kryer për rezultatet e modelit BULRAIC më 10.06.2010-10.07.2010, përfshirë komentet e operatorëve dhe qëndrimin për këto komente.

Vodafone kometon se reduktimi i tarifës së terminimit në rrjetet celulare do të krijojë presion për mos-ndryshim madje edhe për rritje të tarifave me pakice, sidomos për parapagim, duke dhënë referenca në një studim dhe në analizën e fundit të OFCOM për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare.

Qëndrimi i AKEP:

Debati për efektin e reduktimit të tarifave të terminimit në tarifat me pakicë celulare, është i hershëm dhe argumentat e operatorëve celularë për efektin ‘waterbed’ nuk janë provuar ndonjëherë empirikisht, megjithëse Vodafone referon një studim³ që ka provuar ekzistencën e këtij efekti. Për sa i përket referencës me analizën e fundit të OFCOM, vëmë në dukje se debati është i përqëndruar nëse duhet të përdoret LRIC i pastër apo LRIC+. Megjithatë, theksojmë se Mbretëria e Bashkuar është ndër shtetet e para që ka implementuar LRIC dhe ka propozuar të implementojë LRIC e pastër sipas rekomandimit të fundit të BE, që do të reduktojë akoma më ndjeshëm tarifat e terminimit në rrjetet celulare. Gjithashtu, AKEP vë në dukje se reduktimet e shumta dhe të ndjeshme të tarifave të terminimit në rrjetet celulare në vendet e BE në vitet e fundit të shoqëruara dhe me reduktime të tarifave të Romingu-t, janë shoqëruar me reduktime të tarifave celulare me pakicë të matura me shpenzimet për shportat OECD (siç mund të shihet nga figura e mëposhtëme), pra që përbën një argument për mungesë të efektit ‘waterbed’. Një qëndim i ngjashëm ndaj argumentit ‘waterbed effect’ është përdorur edhe nga konsulenti ICC, në qëndrimin ndaj komenteve të operatorëve për rezultatet e modelit dhe Vodafone mund t’i referohet këtij dokumenti për më shumë detaje.

Figura: Ecuria e tarifave celulare me pakicë (shporta OECD: Euro/muaj) dhe tarifave me shumicë të terminimit (eurocent/minutë)⁴



³ Studimi i financuar nga Vodafone Group

⁴ Të dhënat janë marrë nga raportet e implementimit të BE.

ANEKS 2:
Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT
Dokumenti final



AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**ORIENTIMI NË KOSTO I TARIFAVE TË
SHËRBIMEVE CELULARE TË OPERATORËVE ME
FNT¹**

DOKUMENTI FINAL

Tiranë më 10.02.2011

¹ Dokument i Miratuar me VKD nr.1505, datë 10.02.2011, si Aneks 2 i këtij vendimi.

Përmbajtja

1. Hyrje	1
2. Baza ligjore dhe vendimet për FNT	2
3. Projekti dhe Modeli BULRAIC	4
4. Përvoja e vendeve të BE dhe rajonit	7
5. Orientimi në kosto i tarifave të terminimit	10
6. Tarifat e shërbimeve të tjera të interkoneksionit	15
7. Ndikimi në tarifat e shërbimeve me pakicë.....	17

1. Hyrje

Ky dokument është përgatitur nga AKEP, në përfundim të konsultimit publik të dokumentit të “Orientimi në Kosto i Tarifave të Shërbimeve Celulare të Operatorëve me FNT”, konsultim i kryer më 29.12.2010-29.01.2011, dhe vendimeve nr.1210, nr.1211 dhe nr.1212, datë 31.03.2010, për shpalljen me FNT dhe vendosjen e masave rregulluese për AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile, të ndryshuara me vendimet nr. 1345, nr.1346 dhe nr.1347 datë 23.07.2010, dhe me vendimet nr.1436, nr.1437 dhe nr.1438, date 03.11.2010, si dhe të rezultateve përfundimtare të projektit “Konsulencë ndërkombëtare për hartimin dhe zhvillimin e modelit BU-LRAIC për llogaritjen e kostove të shërbimeve telefonike të lëvizshme”.

Në përfundim të procesit të konsultimit publik për dokumentin nga palët e interesuara kanë dërguar komente në AKEP, katër operatorët e telefonisë së lëvizshme në tregun e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë. Ky dokument paraqet versionin final të dokumentit të nxjerrë për konsultim publik, në të cilin janë bërë disa ndryshime pas marrjes së komenteve të paleve të interesuara. Në një dokument të veçantë “Qëndrimi i AKEP për kometet e palëve të interesuara” AKEP ka dhënë përgjigje për kometet e operatorëve duke bërë sqarime edhe për ndryshimet e kryera në këtë dokument final. Komentet e plota të operatorëve paraqiten në një dokument të veçantë “Komentet e Operatorëve për orientimin në kosto të tarifave celulare”.

AKEP bazuar në këtë dokument final do të marrë vendimet përkatëse për orientimin në kosto të tarifave celulare me shumicë për operatorët me FNT në tregjet respektive.

Çështjet kryesore të trajtuara në këtë dokument janë:

- Baza ligjore dhe vendimet për FNT për orientimin në kosto të tarifave celulare;
- Rezultatet e modelit BULRAIC celulare;
- Rekomandimet e KE dhe përvoja në vendet e BE dhe vendet e rajonit;
- Orientimi në kosto i tarifave të terminimit;
- Tarifat e shërbimeve të tjera të interkoneksionit;
- Ndikimi në tarifat e shërbimeve me pakicë.

2. Baza ligjore dhe vendimet për FNT

AKEP bazuar në analizën e tregut celular me vendimet nr.1210, nr.1211 dhe nr.1212, datë 31.03.2010, përcaktoi AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile si sipermarrës me FNT për shërbimet e mëposhtme:

- AMC:
 - o terminimi i thirrjeve në rrjetin AMC
 - o akses/origjinimi i thirrjeve në rrjete celulare
- Vodafone Albania:
 - o terminimi i thirrjeve në rrjetin Vodafone Albania
 - o akses/origjinimi i thirrjeve në rrjete celulare
- Eagle Mobile:
 - o terminimi i thirrjeve në rrjetin Eagle Mobile.

Nëpërmjet këtyre vendimeve, AKEP përcaktoi dhe masat rregulluese për secilin operator për FNT në tregjet përkatëse respektive. Në lidhje me detyrimin për kontrollin e tarifave, AKEP përcaktoi që:

- Tarifa e terminimit të thirrjeve në rrjetet AMC dhe Vodafone Albania të jetë 10.50 lek/minute dhe 0.31 lek/thirrje, duke qëndruar në nivel të njëjtë me tarifën e mëparshme (në fuqi që prej datës 01.09.2009);
- Tarifa e terminimit në rrjetin Eagle Mobile të jetë 12.20 lek/minute dhe 0.37 lek/thirrje, duke pësuar reduktim nga 13.32 lek/minute dhe 0.40 lek/thirrje të aplikuar nga 1 Shatori 2008;
- Tarifa e origjinimit të thirrjeve në rrjetet AMC dhe Vodafone Albania të jetë 10.50 lek/minute dhe 0.31 lek/thirrje, e njëjtë me tarifën e terminimit të thirrjeve.

AKEP me Vendimet Nr. 1345, Nr. 1346 dhe Nr.1347 date 23.07.2010, bëri disa ndryshime në vendimet e cituar më sipër, të cilat konsistojnë në:

- Tarifa e terminimit të Eagle Mobile të ndryshohet nga 12.20 në 12.92 lek/minute;
- Tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të percjella nga operatorë vendas të jetë objekt i negociatave komerciale midis operatorëve duke filluar nga data 01.11.2010, në ndryshim nga situata deri më tani ku kjo tarifë është nën-rregullim e njëjtë me tarifën e terminimit të thirrjeve kombëtare.

AKEP, me vendimet nr.1436, nr.1437 dhe nr.1438, datë 03.11.2010, anulloi pikën e dytë të cituar më sipër, për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.

Sipas këtyre vendimeve, detyrimi i orientimit në kosto të tarifave, sipas neneve 41, 45 dhe 59 do të implementohet me një vendim të veçantë të AKEP, i cili do të përcaktojë afatin e zbatimit të tarifave aktuale të cituara më sipër. Konsultimi publik i këtij dokumenti është për marrjen nga AKEP të këtyre vendimeve, të cilat do të përcaktojnë modalitetet e orientimit në kosto të tarifave të operatoreve me FNT, për të cilat është vendosur ky detyrim.

Në bazë të përcaktimeve të Ligjit 9918:

- Neni 41 përcakton detyrimin për mbajtjen e llogarive për shërbimet për të cilat kanë FNT, sidomos sipërmarrësit e integruar vertikalisht. Mbajtja e llogarive duhet të bëhet sipas një formati dhe metodologjie të veçantë, të cilat duhet të përcaktohen nga AKEP. Këto detyrime kanë lidhje me detyrimet rregullatore dhe nuk bien ndesh apo përjashtojnë detyrimet sipas legjislacionit tatimor apo ligji i kontabilitetit për të gjitha shoqëritë tregtare që operojnë në Shqipëri.
- Neni 45 përcakton të drejtën e AKEP për të vendosur detyrime për kontrollin e tarifave bazuar në kosto dhe sistemet e mbajtjes së llogarive, duke lejuar një normë të arsyeshme fitimi për sipërmarrësin. Bazuar në këtë nen, AKEP përcakton metodologjinë e llogaritjes së koston (FAC, LRIC etj) dhe bazën mbi të cilat llogariten këto kosto (kosto historike apo korrente)
- Sipas nenit 59:
 1. Kur një sipërmarrës ka detyrimin për orientimin e tarifave drejt koston, është i detyruar të provojë që tarifat e shërbimeve të ofruara prej tij janë rrjedhojë e koston eficientë, duke mundësuar një normë fitimi të arsyeshme.
 2. Me qëllim llogaritjen e koston së ofrimit eficient të shërbimeve, AKEP-i përdor metoda të llogaritjes së koston, të pavarura nga ato të përdorura nga sipërmarrësit.
 3. Me kërkesë të AKEP-it, brenda një afati kohor prej 45 ditësh, sipërmarrësi duhet të provojë se tarifat e tij janë të orientuara drejt koston. Nëse sipërmarrësi, brenda afatit të caktuar, dështon në justifikimin e tarifave si më sipër, AKEP-i konsideron se tarifat nuk janë të orientuara drejt koston.
 4. AKEP-i, duhet të sigurojë që sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg, ndaj të cilit është vendosur detyrimi për llogaritjen e koston, të bëjë publikisht të vlefshme përshkrimin e sistemit të llogaritjes së koston, duke treguar të paktën kategoritë kryesore, në të cilat janë grupuar koston dhe rregullat e përdorura për caktimin e kostonve.
 5. AKEP, ose një ekspertizë e kualifikuar e pavarur, e përzgjedhur nga AKEP-i, ka të drejtë të kryejë auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë me sistemin e llogaritjes së koston.

Nga përcaktimet e mësipërme, nga praktikat rregullatore në vendet e BE dhe nga rekomandimet e KE-së:

- AKEP ka të drejtë të vendose detyrime për përlllogaritjen e kostonve eficientë nga operatorët (LRIC);
- AKEP ka të drejtë të përdore metoda BU për përlllogaritjen e kostonve eficientë.
- Në çdo lloj metode të llogaritjes së kostonve, operatorit duhet të lejohet që të fitojë një normë të arsyeshme fitimi.
- Për ndarjen e llogarive AKEP duhet të përcaktojë formatin e tyre;
- Koston e përlllogaritura nga operatorët duhet të auditohen nga AKEP.

3. Projekti dhe Modeli BULRAIC

AKEP gjatë vitit 2008-2009, nëpërmjet procesit të prokurimit publik përzgjodhi kompaninë Britanike InterConnect Communications (ICC në vijim), për zhvillimin e modelit BU-LRAIC (Bottom- Up Long Run Average Incremental Cost) për përcaktimin e kostove të shërbimeve të operatoreve të telefonisë të lëvizshme.

Objekti i këtij projekti ishte hartimi dhe zhvillimi i modelit BU- LRAIC (Bottom- Up Long Run Average Incremental Cost) për përcaktimin e kostove të ofrimit eficient të shërbimeve të operatorëve të telefonisë së lëvizshme që operojnë në një treg konkurues në Shqipëri.

Qëllimi i zhvillimit të modelit ishte që rezultatet e Modelit BU-LRAIC, AKEP ti përdore si input-e në procesin e rregullimit të tarifave të shërbimeve të ofruara nga operatorët e telefonisë së lëvizshme.

Projekti filloi në muajin Qershor 2009 dhe përfundoi në muajin Korrik 2010. Fazat kryesore të projekt ishin:

1. Publikimi i pyetësorëve të të dhënave për operatorët celularë

Konsulenti përdori të dhënat e tregut që disponoheshin nga AKEP si dhe të dhëna më të detajuara nga secili operator, të cilat përfshinin të dhëna operative të aktivitetit për sasinë e shërbimeve të shitura, të dhëna për rrjetet e ndërtuara, të ardhurat dhe të dhëna financiare për kostot e pajisjeve dhe aktivitetit. Konsulenti kishte detyrimin dhe ka bërë rregullime apo plotësime të të dhënave të marra me të dhëna nga vende të tjera, bazuar në eksperiencën e tyre në zhvillimin e modeleve të ngjashme.

2. Zhvillimi i konsultimit publik për Dokumentin Referencë të Modelit (MRP)

Në këtë fazë u trajtuan çështjet/alternativat kryesore të cilat lidhen me zhvillimin e modelit BU-LRAIC:

- Strukturën e modelit: Lart-poshtë apo Poshtë- Lart;
- Objekti: cilët operatorë, cilat shërbime, ç'farë teknologjie;
- Struktura e rrjetit: scorched earth, scorched node, modified scorched node;
- Inkrementi (shtesa) : inkrement i ngushtë kundrejt inkrement i gjerë;
- Trajtimi i kostove:
 - Parimi i shkaktimit të kostove;
 - Ndarja e kostove të trafikut dhe mbulimit;
 - Alokimi i kostove të përbashkëta;
 - Alokimi i kostove të shërbimeve;
 - Pagesat për eksternalitetet e rrjeteve;
 - Trajtimi i pagesave për licensë dhe spektrin e frekuencave;
- Metodat e analizimit: zhvlerësimi (amortizimi) ekonomik dhe përafruesit e tij;
- Kostoja e Kapitalit;
- Tarifat simetrike kundrejt tarifave asimetrike;

3. Ndërtimi i modelit BU-LRAIC dhe konsultimi me operatorët celularë

Pasi ishin përcaktuar zgjedhjet kryesore në lidhje me modelin dhe ishin mbledhur të dhënat e nevojshme, konsulenti ndërtoi modelin BU-LRAIC duke dhënë disa rezultate paraprake. Modeli u konsultua me operatorët celularë të cilët kishin akses në mënyrë të kufizuar apo të plotë në prezencën e konsulentit/AKEP-it, për të parë funksionimin e modelit dhe përdorimin e të dhënave të depozitura prej tyre. Bazuar në komentet e operatorëve në këtë fazë, konsulenti kreu rregullime të modelit.

4. Zhvillimi i konsultimit publik për rezultatet e modelit BU-LRAIC

Në këtë fazë u krye konsultim publik në lidhje me rezultatet e modelit BU-LRAIC, duke përfshirë një paraqitje të modelit të kostove me inputet dhe supozimet kryesore, modelin e parashikimit të ecurisë së pjesëve dhe kërkeses së tregut, dimensionimin e rrjetit dhe llogaritjet e kostove. Konsultimi përfshinte dhe çeshtjet e analizës së ndjeshmërisë si dhe përcaktimin e tarifave të terminimit në rrjetet celularë dhe asimetrine e tyre.

Dokumentacioni i konsultimeve publike është publikuar në faqen e internetit të AKEP-it dhe lexuesi mund t'i referohet këtyre dokumentave për më shumë detaje.

ICC në përfundim të këtij projekti ka dorëzuar në AKEP rezultatet finale të cilat janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1. Output-et e modelit BU-LRAIC me vlerë WACC=17.5%

Shërbimi	Njësia	Kostoja e modeluar (Lekë në 2013)
Terminimi i thirrjeve	minutë	4.57
Origjinimi i thirrjeve	minutë	4.51
Thirrje Brenda rrjetit	minutë	7.17
Tranzit ndërkombëtar	minutë	1.13
Tranzit kombëtar	minutë	1.13
SMS Brenda rrjetit	mesazh	0.60
SMS dalëse	mesazh	0.58
SMS hyrëse	mesazh	0.58
MMS Brenda rrjetit	mesazh	0.27 ²
MMS dalëse	mesazh	0.16
MMS hyrëse	mesazh	0.17
GPRS downloads	megabit	5.14

Bazuar në këto rezultate dhe ICC ka dhënë rekomandime për implementimin e rezultateve në përcaktimin e tarifave të terminimit për katër operatorët celularë, sipas tabelës së mëposhtme:

² Kostot për MMS nuk përfshijnë kostot e MMSC pasi AMC e kryen këtë shërbim jashtë shtetit dhe asnjë operator tjetër nuk dha informacion për kosto për njësi.

Tabela 2: Reduktimi i përshkallëzuar i tarifave të terminimit i rekomanduar nga ICC.

	2009-2010	Nga data e përcaktuar në vendimin e AKEP ³	Nga Shtatori 2011	Nga Shtatori 2012	Nga Shtatori 2013	Nga Shtatori 2014
AMC, Vodafone	10.5	9.03	7.57	6.10	4.57	4.57
Eagle Mobile	12.92	10.31	8.42	6.52	4.57	4.57
Plus Communication		13.32	10.31	8.42	6.52	4.57

Table 5: Revised proposed glide paths

Në tabelë mungon vlera tarifës së Plus Communication në periudhën e parë, pasi në kohën e përfundimit të projektit, vlera e tarifës së terminimit për Plus Communication, nuk ishte e njohur ende.⁴

³ Vendimet që do merren pas këtij konsultimi public.


⁴ Vendimi për përcaktimin e tarifës së terminimit në Plus Communication 18.9 lekë/minutë, u mor më 4.8.2010, me zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis këtij operatori dhe katër operatorëve me FNT.

4. Përvoja e vendeve të BE dhe rajonit

Figura e mëposhtme paraqet vlerat e tarifave të terminimit në rrjetet celulare në vendet e BE, të publikuara në raportin e 15 të implementimit të KE, ku tarifa mesatare në vendet e BE për vitin 2009 ishte 6.7 Eurocent.

Figura 1: Tarifatat e terminimit në rrjetet celulare në vendet e BE (2009)

Figure 14: IC charges for call termination on mobile networks



Burimi: Raporti i 15-të i Implementimit të BE

Sipas të dhënave të BEREC⁵ (ish ERG) tarifa mesatare në vendet anëtare të ERG (vendet e BE plus disa vende të tjera Europiane) më 01.01.2010 është 6.30-6.69 Eurocent/minutë (në varësi të llojit të mesatares aritmetike apo e ponderuar dhe kohes peak/off peak/total).

Komisioni Europian në rekomandimet e tij që prej vitit 2002, ka theksuar që tarifatat e akses/interkoneksionit për operatorët me FNT duhet të reflektojnë koston e ofrimit të tyre prej një operatori eficient, që operon në një treg konkurrues dhe metodologjia e kostove që nxjerr rezultate të tilla është LRIC. Për këtë metodologji ekzistojnë dy metoda kryesore BU dhe TD. Për aplikimin e BU ekzistojnë një sërë zgjedhjesh metodologjike, që duhen kryer para zhvillimit të modelit (të cituara edhe në seksionin 3). Përsa i përket bazës së kostove (cost base) KE rekomandon përdorimin e kostove korrente.

⁵ BoR (10) 30rev1: MTR Benchmark snapshot (as of January 2010)

Ndërkohë në lidhje me detyrimin për ndarjen e llogarive, detyrim që shërben kryesisht për kontrollin e përputhshmerisë së zbatimit të detyrimit të mos-diskriminimit, KE nëpërmjet ERG ka dhënë rekomandime për zbatimin e këtij detyrimi, ndërkohë që sic përcaktohet edhe në nenin 41 të ligjit nr. 9918, është e nevojshme që autoriteti rregullator të specifikojë rregullat për ndarjen e llogarive.

Rregulla të tilla duhet të publikohen nga rregullatori dhe për sistemin e mbajtjes së llogarive rregullatore (HC apo CC) dhe kategoritë kryesore/rregullat e alokimit. Ky detyrim vendoset për operatorët që të justifikojnë tarifat e propozuara që ato janë të orientuara në kosto.

Dokumenti i ERG “(09) 41 ERG Report: Regulatory Accounting in Practice 2009”, ka dhënë një përmbledhje të praktikave në vendet e BE në lidhje me aplikimin e detyrimit për orientim në kosto dhe zgjedhjet e bëra nga rregullatorët në lidhje me llojet dhe metodologjitë e kostove për të kontrolluar tarifat në tregjet përkatëse, ku është vendosur ky detyrim për FNT. Sipas të dhënave të këtij raporti, për tregun e terminimit të thirrjeve në një rrjet celular, rezulton se metoda më e përdorur është LRIC (LRAIC).

Tabela 3: Praktika në vendet e BE për orientimin në kosto të tarifave të terminimit celular

	Baza e kostove (Cost base)	Sistemi alokimit të kostove/modeli I kostove	Metoda e kontrollit të çmimeve
Alternativat	Kosto Historike (HCA), Kosto Korrente (CCA) apo të tjera:	<i>LRIC, LRAIC apo FDC</i>	<i>Price Cap, Retail Minus, Cost orientation/Cost accounting, Benchmarking te tjera</i>
BE	65% CCA	LRIC/LRAIC 54% nga 24 vende të BE 67% nga 15 vende që kanë raportuar që nga viti 2006	73% Cost Orientation

Burimi: Dokumenti i ERG “(09) 41 ERG Report: Regulatory Accounting in Practice 2009”

Në vëndet e rajonit të SEE, bazuar në raportin e Cullen International në mars 2010, modelet LRIC janë aplikuar/parashikohen të aplikohen në Turqi, Maqedoni dhe Kroaci. Turqia ka imponuar BU, ndërsa Maqedonia TD. Kroacia nuk ka vendosur ende. Në vëndet e tjera rregullimi i tarifave të terminimit kryhet me metodën “benchmark”.

Komisioni European në rekomandimin më të fundit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit: **COMMISSION RECOMMENDATION of 7 May 2009 on the Regulatory Treatment of Fixed and Mobile Termination Rates in the EU (2009/396/EC)**, ka rekomanduar autoriteteve rregullatore, midis të tjerave:

- Përcaktimin e tarifave të terminimit (fiks dhe celular) bazuar në kostot e ofrimit nga një operator eficient. Kjo nënkupton gjithashtu që tarifat duhet të jenë simetrike;
- Vlerësimi i kostove eficientë të bazohet në kostot korrente dhe përdorimin kostove afatgjate inkrementale me metodën BU, si metodologjia e duhur e kostove;

- Mund të përdorin krahasimin e rezultateve të modelit BU me model TD i cili përdor të dhëna të audituara për të përmirësuar konsistencën e rezultateve dhe mund të bëjnë rregullimet e nevojshme;

Rekomandimi përcakton dhe disa zgjedhje që duhen bërë në modelimin BU, ku më i rëndësishmi duket së është përdorimi i LRIC për shërbimin e terminimit d.m.th inkrementi të jetë vetëm terminimi dhe jo të gjitha shërbimet si në rastin e LRAIC. Pritshmeritë për aplikimin e të gjitha zgjedhjeve të rekomandimit të KE, është se tarifa e terminimit në rrjete celulare në fundin të vitit 2012 pritet të jetë shumë më ulët se niveli aktual. Kjo çështje ka qënë objekt diskutimi në modelin BULRAIC të ndërtuar nga ICC, dhe lexuesit mund t'i referohen dokumentave të publikuar nga AKEP për modelin BULRAIC.

5. Orientimi në kosto i tarifave të terminimit

Bazuar në përcaktimet e Ligjit 9918, rekomandimet e KE dhe praktiken më të mirë në vendet e BE dhe të rajonit, AKEP gjykon se tarifat e terminimit në rrjetet celulare duhet të jenë të orientuara në koston efiçente të ofrimit të përlogarituar sipas modelit BU me metodologjinë LRAIC të ndërtuar nga AKEP (me konsulencën e ICC).

Bazuar në rezultatet dhe rekomandimet e ICC për tarifat e terminimit në rrjetet celulare sipas rezultateve të modelit BULRAIC, AKEP në seksionet në vijim, paraqet propozimin për orientimin në kosto të tarifave të terminimit në rrjetet celulare.

Kosto e kapitalit

Siç përcaktohet në disa nene të ligjit nr. 9918, në rregullimin e tarifave bazuar në koston efiçente të ofrimit të tyre, AKEP duhet të lejojë sipërmarrësin që të sigurojë një normë fitimi të arsyeshme mbi kapitalin e punësuar që merr në konsideratë riskun e aktivitetit të tij. Për përcaktimin e normës së arsyeshme të fitimit, përdoret koeficienti i koston mesatare të ponderuar të kapitalit (WACC). ICC në përlogaritjet e koston së kapitalit, për operatorët celularë në Shqipëri, ka arritur në përfundimin se vlera nominale para tatimit e WACC është 17.5%, dhe bazuar në këtë vlerë të WACC, vlera e koston së terminimit, përfshirë fitimin e arsyeshëm, pra tarifa e terminimit, është përlogaritur të jetë 4.57 lek/minutë. Ndërkohë ICC ka bërë përlogaritje se si ndikon vlera e WACC në tarifën e terminimit të orientuar në koston BULRAIC. Këto vlera janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tabela 4: Rezultatet e analizave të ndjeshmërisë për WACC

Variabli	Vlera	Kosto e terminimit (Lekë/minutë 2013)
Skenari bazë	17.5%	4.57
Ndjeshmëria e WACC:		
	18.50%	4.73
	19.50%	4.89
	20%	4.98
	22%	5.32

AKEP gjykon se përdorimi i vleres 17.5% për WACC, dhe tarifës respektive 4.57 lekë/minutë është i arsyeshëm për t'u përdorur për rregullimin e tarifës së terminimit të operatorëve celularë në Shqipëri.

Reduktimi i përshkallëzuar dhe asimetria

Në rekomandimet për orientimin në kosto të tarifave të terminimit nga KE dhe ERG (BEREC), si dhe nga praktikat rregullatore në vende të BE, vihet re se orientimi në kosto shpesh rekomandohet të kryhet nëpërmjet një reduktimi të përshkallëzuar, në rastet kur reduktimi është i ndjeshëm me qëllim që ky reduktim të mos shkaktojë probleme disproporcionale për operatorët në tregjet përkatës.

Ndryshimi midis vlerës aktuale të tarifës së terminimit dhe tarifës së orientuar në kosto është i ndjeshëm: 5.52-13.92 lek/minutë. Ndryshime të tilla të ndjeshme, rekomandohen që të aplikohen në mënyrë të përshkallëzuar.

Gjithashtu, në lidhje me asimetrinë, KE rekomandon që tarifat e terminimit duhet të jenë simetrike, pasi sipas parimit të kostove efçente të një operatori në treg konkurrues, nuk duhet të ketë dallim në koston/tarifën e aplikuar. Megjithatë në rastet kur asimetria është e justifikuar, ajo duhet të jetë e kufizuar në kohë duke u reduktuar dhe më pas eliminuar brenda një periudhe kohore të përshatshme. Siç është theksuar në dokumentin e analizës së tregut dhe qëndrimet e mëparshme të AKEP, nëpërmjet vendimeve që do të merren pas këtij konsultimi publik, AKEP do të përcaktojë kohëzgjatjen e asimetrisë dhe kohën kur tarifat e katër operatorëve aktual do të konvergojnë në të njëjtën tarifë.

Tabela e mëposhtme paraqet vlerat aktuale të tarifave të terminimit të katër operatorëve në treg, dhe ndryshimin e nevojshëm që këto tarifa të jenë të orientuar në kosto.

Tabela 5: Tarifat aktuale të terminimit dhe të bazuar në kosto BU-LRAIC

	Tarifa Aktuale (lekë/minutë)	Tarifa sipas koston (lekë/minutë)	Reduktimi i nevojshem (%)
AMC	10.50	4.57	-56%
Vodafone Albania	10.50	4.57	-56%
Eagle Mobile	12.92	4.57	-65%
Plus Communication	18.90	4.57	-76%

Meqënëse reduktimet e tarifave janë të ndjeshme për të katër operatorët aktualë në treg, AKEP gjykon se aplikimi i reduktimit të përshkallëzuar, është mënyra e drejtë e zbatimit të orientimit në kosto. Për afatet kohore të reduktimit të përshkallëzuar dhe reduktimit/eliminimit të asimetrisë, AKEP në procesin e konsultimit publik propozoi që tarifat e katër operatorëve celulare të reduktohen sipas afateve dhe vlerave në tabelën e mëposhtme (përcaktimi i vlerave maksimale të tarifave).


Tabela 6: Reduktimi i përshkallëzuar i tarifave të terminimit në rrjetet celulare për orientim në kosto BULRAIC (lekë/minutë)⁶ (Konsultimi publik)

	Aktuale	1 Mars 2011	1 Shtator 2011	1 Shtator 2012	1 Shtator 2013	1 Shtator 2014
AMC, Vodafone	10.5	8.85	7.57	6.1	4.57	4.57
Eagle Mobile	12.92	10.89	8.42	6.52	4.57	4.57
Plus Communication	18.9	15.93	12.92	8.42	6.52	4.57

⁶ Tarifat e reja, në ndryshim nga praktika e deritanishme, nuk do të përfshijnë tarifë për thirrje.

Ndërkohe, AKEP duke marrë në konsideratë komentet e operatorëve për asimetrinë relative të tarifave midis operatorëve dhe kohëzgjatjen e asimetrise për Plus, ve re se vlerat e tarifave të terminimit të propozuara nga AKEP janë vërtet në rënie për të gjithë operatorët, por në disa faza asimetria relative midis Plus dhe AMC/Vodafone dhe EM vjen në rritje pas një faze uljeje të saj: në fazën 2 (Shtator 2011) asimetria Plus/EM rritet nga 46% në 53%, në fazën 4 (Shtator 2011) asimetria Plus/EM rritet nga 29% në 43% dhe në të njëjtën fazë asimetria Plus/AMC-Vodafone rritet nga 38% në 43% (për më shumë shiko Figurën e mëposhtme 2).

Figura 2: Ndryshimet e asimetrisë midis operatorëve (propozimi konsultim publik)



Duke qënë se asimetria relative (në përqindje) e tarifave midis operatorëve në treg luan një rol të rëndësishëm dhe se rekomandimet e BE dhe praktiket më të mira rregullatore rekomandojnë që asimetria të vijë në ulje, AKEP gjykon se vlerat e tarifave të terminimit për Plus dhe EM të rishikohen për të shmangur këtë problem. Njëkohësisht, në këtë rishikim AKEP ka marrë në konsideratë komentet e Plus për kohëzgjatje të njëjtë të asimetrisë prej 5 vjet si edhe për EM. AKEP ka bërë një rishikim të vlerave të tarifave të terminimit të propozuara në dokumentin e hedhur për konsultim publik më 29.12.2010, duke bërë disa ndryshime si më poshtë:


- Tarifa e terminimit për t'u aplikuar në rrjetin EM më 01.09.2011 të rritet nga 8.42 në 8.85 lekë/minutë (e njëjtë me tarifën që do aplikohet në rrjetet AMC/Vodafone në periudhën 01.03.2011-31.08.2011);
- Tarifat e terminimit të rekomanduara për Plus për fazat 3 (01.09.2012) dhe 4 (01.09.2013) të ndryshojnë nga 8.42 dhe 6.52 lekë/minutë, në 8.85 dhe 6.1 lekë/minutë respektivisht;
- Për Plus tarifa e terminimit të konvergojë me atë të tre operatorëve të tjerë në vlerën 4.57 lekë/minutë në 01.09.2015, në vend të 01.09.2014 të propozuar në konsultim publik, duke aplikuar vlerën 5.3 lekë/minutë në 01.09.2014.

Vlerat sipas këtyre ndryshimeve dhe vlerat që AKEP do të përdorë për rregullimin e tarifave të terminimit të operatorëve me FNT janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

Tabela 7: Reduktimi i përshkallëzuar i tarifave të terminimit në rrjetet celulare për orientim në kosto BULRAIC (lekë/minutë) (Finale)

	Aktuale ⁷	1 Mars 2011	1 Shtator 2011	1 Shtator 2012	1 Shtator 2013	1 Shtator 2014	1 Shtator 2015
AMC, Vodafone	10.5	8.85	7.57	6.1	4.57	4.57	4.57
Eagle Mobile	12.92	10.89	8.85	6.52	4.57	4.57	4.57
Plus Communicatio n	18.9	15.93	12.92	8.85	6.1	5.3	4.57


Figura 3: Reduktimi i përshkallëzuar i tarifave të terminimit në rrjetet celulare për orientim në kosto BULRAIC (lekë/minutë) (Finale)



Në bazë të këtyre ndryshimeve, asimetria relative midis operatorëve vjen duke u zvogëluar dhe nuk ka faza me rritje të asimetrisë, siç mund të vihet re nga Figura 4 më poshtë.

⁷ Tarifat aktuale përfshijne një tarifë fikse për thirrje që është e barabartë me 3% të tarifës për minutë. Tarifat e periudhave të tjera, duke filluar nga 1 Mars 2011 nuk përmbajnë tarifë fikse për thirrje.

Figura 4: Ndryshimet e asimetrisë midis operatorëve (finale)



Pra pas ndryshimeve të bëra, sipas tabelës së mësipërme:

- Tarifat e të katër operatorëve fillojnë të reduktohen më 01.03.2011, ku për AMC dhe Vodafone tarifa e terminimit barazohet me tarifën mesatare në vendet e BE në vitin 2009, të publikuar në Raportin e 15-të KE, prej 6.7 eurocent duke përdorur kursin mesatar të këmbimit prej 132.06 Lekë/Euro për vitin 2009.
- Për EM dhe Plus Communication reduktimi në fazën e parë parashikohet të kryhet duke ruajtur asimetrinë aktuale në terma relativë me AMC/Vodafone.
- Asimetria midis tarifave EM dhe AMC/Vodafone, Plus dhe AMC/Vodafone, Plus dhe EM, ruhet në periudhën e parë ose të dytë dhe më pas vjen gjithmonë në rënie deri në zero.
- Tarifat e AMC, Vodafone dhe EM konvergojnë në 1 shtator 2013, në vlerën e llogaritur të BU-LRAIC 4.57 lekë/minutë;
- Tarifa e Plus Communication konvergon me tarifën e tre operatorëve të tjerë në vlerën 4.57 lekë/minutë më 1 Shtator 2015.

Tarifa aktuale e terminimit në rrjetin Plus Communication, është përcaktuar me Vendimin e KD të AKEP nr. 1351, datë 04.08.2010, në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjes midis këtij operatori dhe 4 operatorëve me FNT, për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit. Sipas këtij vendimi, tarifa e terminimit të thirrjeve prej 18.9 lekë/minutë (dhe 0.57 lekë/thirrje) dhe terminimit të SMS-ve prej 4 lekë/SMS, do të aplikohen me një afat maksimal deri më 31.08.2011. Në kuadër të përcaktimit të tarifës së terminimit të Plus Communication për periudhat e dhëna në tabelë, meqenëse Plus Communication formalisht (me vendim të AKEP) nuk ka status me FNT, vlerat e dhëna në tabelë do të shërbejnë si tarifë rekomanduese për këtë operator, deri në shpalljen me FNT të këtij operatori për terminimin e thirrjeve në rrjetin e vet.

Rregullimi i tarifave të terminimit në rrjetet celulare në Shqipëri është bërë shpesh me njoftime të vendimeve të AKEP në afate kohore të shkurtër, e cila ka sjellë që jo vetëm të ndikojë në planet e biznesit të kompanive, por edhe në vonesa të implementimit të tarifave të reja, për shkak të procedurave formale ligjore të apelimeve. Marrja e vendimit nga AKEP për nivelin e tarifave të terminimit në katër rrjetet celulare, për një periudhë 4 vjecare, krijon një precedent të ri i cili ka efekte pozitive në treg, jo vetëm për reduktimin e nivelit të tarifave, por edhe në mundësitë që u krijohen të gjithë lojtarëve në treg për përshtatjen e planeve afatgjate të biznesit.

6. Tarifat e shërbimeve të tjera të interkoneksionit

1. Origjinimi i thirrjeve

AKEP bazuar në analizën e tregut celular me vendimet nr. 1210, nr. 1211, datë 31.03.2010, përcaktoi AMC dhe Vodafone Albania si sipërmarrës me FNT për shërbimet e akses/origjinimit të thirrjeve në rrjete celulare, duke përcaktuar:

- Tarifa e aksesit dhe origjinimit të thirrjeve dhe shërbimeve të interkoneksionit të lidhura me aksesin dhe origjinimin e thirrjeve në rrjetin AMC janë:
 - i. Objekt kontrolli nga AKEP për shërbime të origjinimit të thirrjeve drejt numrave të ofruesve të thirrjeve me karta të parapaguara (OSHKP) dhe numrave pa pagesë 0800xxx:
 - a. Tarifa maksimale e origjinimit të thirrjeve në rrjetin AMC, të jetë 10.50 lekë/minutë dhe tarifë 0.31 lekë/për thirrje.
 - b. Tarifa aplikohet për **kohëzgjatjen e thirrjes** (dhe numrin e thirrjeve) së suksesshme drejt platformës së OSHKP apo call center.
 - c. Zbatimi i detyrimit të ndarjes së llogarive dhe mbajtjes së llogarive (nenet 42 dhe 45) dhe zbatimi i detyrimit të orientimit në kosto të tarifave të interkoneksionit (neni 59), nga sipërmarrësi AMC Sh.a, do të kryhet në bazë të përcaktimeve të mëvonshme të AKEP.
 - ii. Objekt negociatash komerciale për shërbimet e tjera të akses dhe origjinimit të thirrjeve përfshirë MVNO, rishitës të shërbimeve celulare të sipërmarrësit AMC Sh.a.

AKEP, gjykon që tarifat e origjinimit të thirrjeve, që janë nën kontroll, për AMC dhe Vodafone Albania të aplikojë të njëjtat masa rregulluese të propozuar për terminimin e thirrjeve dhe vlera të njëjta me tarifën e terminimit sipas reduktimit të përshkallëzuar të dhënë në tabelën e mëposhtme:

Tabela 7: Reduktimi i përshkallëzuar i tarifave të origjinimit në rrjetet celulare për orientim në kosto BU-LRAIC (lekë/minutë)⁸

	Aktuale	1 Mars 2011	1 Shtator 2011	1 Shtator 2012	1 Shtator 2013	1 Shtator 2014
AMC, Vodafone	10.50	8.85	7.57	6.10	4.51	4.51

⁸ Tarifat e reja, në ndryshim nga praktika e deritanishme, nuk do të përfshijnë tarifë për thirrje.

2. SMS

Rezultatet e modelit tregojnë, se kostoja për terminimin e mesazheve SMS është 0.58 lekë/SMS, e cila është shumë më e ulët se tarifa aktuale e terminimit prej 4 lekë/SMS. AKEP, gjykon se tarifa aktuale e terminimit të SMS në nivel 7 herë më të lartë se kostoja e ofrimit eficient, ka ndikim tepër negativ në zhvillimin e konkurrencës për këtë segment të tregut dhe përfitimet e konsumatorëve për këtë shërbim. Meqënëse AKEP nuk ka kryer analizë për këtë shërbim, dhe nuk ka operatorë me FNT, gjykon që të japë tarifa rekomanduese për terminimin e SMS-ve, të cilat mund të aplikohen nga vetë operatorët celularë. Tarifat rekomanduese për terminimin e SMS-ve janë dhënë në tabelën 8. Operatorët celularë mund të bëjnë reduktim të vullnetshëm të tarifave të terminimit të SMS-ve, nëpërmjet negociatave të cilat duhet të tentojnë aplikimin e tarifave maksimale sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 8: Reduktimi i përshkallëzuar i tarifave të terminimit të SMS-ve në rrjetet celulare për orientim në kosto BU-LRAIC (lekë/minutë)

	Aktuale	1 Mars 2011	1 Shtator 2011	1 Shtator 2012	1 Shtator 2013
AMC Vodafone Eagle Mobile Plus Communication	4.00	2.40	1.44	0.86	0.58

Ndërkohë AKEP ka filluar tashmë kryerjen e një analize për FNT për terminimin e SMS-ve dhe do të ndjekë procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 9918 dhe Rregulloren për Analizën e tregut, si edhe rekomandimet e BE dhe praktikën rregullatore në këto vende për këtë shërbim, që siç citohet edhe nga AMC ka praktikë në disa vende të BE për rregullimin e tarifave të terminimit të SMS-ve në rrjetet celulare. AKEP, ka planifikuar që dokumenti i analizës për terminimin e SMS-ve të publikohet për konsultim publik rreth fundit të muajit Shkurt 2011, dhe sipas procedurës për konsultim dy mujor të analizës së tregut. AKEP mund të marrë vendime për FNT në këto tregje dhe masat rregulluese përkatëse në varësi të përfundimeve të analizës, rreth muajit Maj 2011. Vlen të theksohet se përcaktimet e Ligjit 9918, lejojnë AKEP të ndërhyjë në rregullimin e tarifave të shërbimeve edhe për operatorë që nuk kanë fuqi të ndjeshme në treg, dhe në këtë rast, bazuar në diferencën midis tarifës së terminimit dhe koston dhe interesin publik, mund të justifikohet një ndërhyrje e tillë. AKEP do të monitorojë sjelljen e lojtarëve në lidhje me rekomandimin e mësipërm si dhe alternativat e ndërhyrjeve në rast të mos-reduktimit të vullnetshëm të tarifës së terminimit të SMS-ve nga operatorët celularë.

7. Ndikimi në tarifat e shërbimeve me pakicë

Reduktimet e tarifave të interkoneksionit në nivelet e përshkruara në seksionet 5-6, pritet të kenë efekt pozitiv në tregjet me pakicë të shërbimeve celulare dhe të telefonisë fikse. Ndikimi në telefoninë fikse do të jetë direkt në pagesa më të ulëta për terminimin e thirrjeve dhe në kosto më të ulëta për thirrjet telefonike fiks-celulare, pra dhe në tarifa më të ulëta për këto thirrje. Gjithashtu, reduktimi i diferencës midis tarifave të terminimit në rrjetet celulare dhe fiks do të ndikojë pozitivisht në aftësinë konkurruese të operatorëve fiks, edhe me shërbimet celulare, ku vihet re një efekt zëvendësimi më i ndjeshëm se në vitet e mëparshme.

Efekti i reduktimit të tarifave të terminimit në rrjetet celulare do të ndikojë në rritjen e konkurrencës në tregun celular, nëpërmjet:

- Uljes së kostos së thirrjeve off-net celulare për operatorët duke krijuar mundësinë e reduktimit të tarifave të këtyre thirrjeve në tregun me pakicë të shërbimeve celulare, të cilat aktualisht janë në nivele të larta.
- Reduktimit të mundësive të operatorëve celulare për subvencionimin e thirrjeve telefonike në nivelin retail, një praktike e vënë re sidomos me thirrjet brenda grupeve të mbyllura të përdoruesve.


Tarifat aktuale të thirrjeve jashtë rrjetit dhe të SMS-ve, brenda dhe jashtë rrjetit, në shumicën e programeve tarifore, përveç promocioneve dhe programeve të caktuara, duket se janë shumë më të larta se kotoja e ofrimit eficient të tyre (përfshirë edhe një vlerësim për koston retail). Reduktimi i tarifave të terminimit për këto shërbime, duhet që në kushtet e konkurrencës efektive në tregun me pakicë të shoqërohet apo ndjehet në reduktime të tarifave me pakicë për këto shërbime.

Bazuar në vlerat e kostove BULRAIC të thirrjeve brenda grupit, dhe problemeve të evidentuara më sipër dhe në analizën e tregut celular, ekziston mundësia e vendosjes së çmimeve dyshme apo minimale (price floor) me qëllimin e eliminimit të mundësisë së 'price squeeze'. Megjithatë një masë e tillë rregulluese në tregun me pakicë mund të vendoset vetëm për operatorët me FNT, dhe bazuar në vendimet dhe Analizën e tregut celular të AKEP, në tregun celular me pakicë nuk ka operatorë me FNT. Ky përfundim i AKEP dhe vendimi për të hequr detyrimet e rregullimit të tarifave me pakicë të AMC dhe Vodafone, është në përputhje dhe me rekomandimet e KE për përdorimin e masave rregulluese me pakicë vetëm nëse masat rregulluese me shumicë nuk janë efektive. Njëkohësisht AKEP ka vendosur masa rregulluese në tregjet me shumicë të terminimit (tre operatorët aktivë celularë) dhe tregun me shumicë të origjinimit, të cilat së bashku me reduktimet e parashikuara të tarifave me shumicë pritet të kenë efekt pozitiv në tregun me pakicë celular. Gjithashtu, vendosja e kontrolleve të tilla në tregjet me pakicë mund të kufizojë aftësinë konkurruese të operatorëve të rinj në treg si EM dhe Plus Communication, duke i kufizuar në politikat tarifore.

AKEP, parashikon që ndikimi i reduktimit të tarifave të terminimit në rrjetet celulare në konkurrencën në tregun me pakicë celular, të jetë më i madh se thjesht reduktimi i tarifave të thirrjeve jashtë rrjetit në masë të njejte me reduktimin absolut të tarifave të terminimit. Këto reduktime të tarifave të thirrjeve pritet të shoqërohen me reduktime të tarifave të SMS-ve (për shkak të reduktimit edhe të tarifave të terminimit të SMS-ve) ku pritet të çojnë në reduktime të mëtejshme të tarifave celulare dhe më të mëdha se ato që kanë ndodhur dy vitet e fundit.

AKEP nuk është dakort me komentet e operatorëve celularë gjatë konsultimit publik se reduktimi i terminimit krijon efektin e presionit për mos-reduktim madje për rritje të tarifave me pakicë, sidomos me parapagim. Debati për efektin e reduktimit të tarifave të terminimit në tarifatat me pakicë celulare, është i hershëm dhe argumentat e operatorëve celularë për efektin ‘ëaterbed’ nuk janë provuar ndonjëherë empirikisht, megjithëse Vodafone referon një studim⁹ që ka provuar ekzistencën e këtij efekti. Për sa i përket referencës me analizën e fundit të OFCOM, vëmë në dukje se debati është i përqëndruar nëse duhet të përdoret LRIC i pastër apo LRIC+. Megjithatë, theksojmë se Mbretëria e Bashkuar është ndër shtetet e para që ka implementuar LRIC dhe ka propozuar të implementojë LRIC e pastër sipas rekomandimit të fundit të BE, që do të reduktojë akoma më ndjeshëm tarifatat e terminimit në rrjetet celulare. Gjithashtu, AKEP vë në dukje se reduktimet e shumta dhe të ndjeshme të tarifave të terminimit në rrjetet celulare në vendet e BE në vitet e fundit të shoqëruara dhe me reduktime të tarifave të Romingu-t, janë shoqëruar me reduktime të tarifave celulare me pakicë të matura me shpenzimet për shportat OECD (siç mund të shihet nga figura e mëposhtme), pra që përbën një argument për mungesë të efektit ‘waterbed’. Një qëndim i ngjashëm ndaj argumentit ‘waterbed effect’ është përdorur edhe nga konsulenti ICC, në qëndrimin ndaj komenteve të operatorëve për rezultatet e modelit dhe Vodafone mund t’i referohet këtij dokumenti për më shumë detaje.

Figura 5: Ecuria e tarifave celulare me pakicë (shporta OECD: Euro/muaj) dhe tarifave me shumicë të terminimit (eurocent/minutë)¹⁰



⁹ Studimi i financuar nga Vodafone Group

¹⁰ Të dhënat janë marrë nga raportet e implementimit të BE.